



KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE

GRUPI I PUNËS

TERMAT E REFERENCËS

LOTI 1

***“FURNIZIMI NË VEND ME LËNDË DJEGËSE I TERMOCENTRALEVE LUNDRUESE,
TRIPORT, VLORË”***

Tiranë 2024

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. PËRSHKRIMI I NEVOJËS	5
3. LËNDA DJEGËSE DHE VENDODHJA E FURNIZIMIT	6
4. LIDHJA DHE KOHËZGJATJA E KONTRATËS	6
4.1. KUSHTET E SHËRBIMIT	8
5. QËLLIMI	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
6. OBJEKTI I PUNËS SË OPERATORIT EKONOMIK (OE) ...	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
6.1. KARAKTERISTIKAT E SHËRBIMIT	10
6.2. FORMA E OFRIMIT E KËRKUAR	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
7. PARASHIKIME TË TJERA	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
8. DOKUMENTACIONI TEKNIK	10

1. HYRJE

Këto terma reference përcaktojnë kërkesat për realizimin e shërbimit të furnizimit në vend me lëndë djegëse, që do të përdoret nga TEC Lundrues me adresë triport, Vlorë, në përdorim të shoqërisë KESH sh.a.

2. PËRSHKRIMI I NEVOJËS

KESH është kompania më e madhe e prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri, që operon hidrocentralet më të rëndësishme në vend dhe mbulon rreth 70-75% të kërkesës për konsum.

KESH është gjithashtu një furnizues i shërbimeve të sistemit për rrjetin shqiptar, si mbulimi i humbjeve nga rrjeti i transmetimit apo balancimi i energjisë.

Nëpërmjet VKM Nr. 757, datë 21 Dhjetor 2021, për “Disa ndryshime në VKM Nr. 620, datë 22 Tetor 2021”, nëpërmjet të cilit Qeveria e Shqipërisë autorizon KESH sh.a., që në përputhje me nevojat dhe mundësitë që do të paraqiten, t’i drejtohet tregut ndërkombëtar për të marrë përkohësisht (1-2 vjet) me qira, asete gjeneruese termike shtesë, të cilat mund të instalohen dhe lidhen lehtësisht me Rrjetin e Transmetimit të Energjisë në Shqipëri.

Në bazë e për zbatim të këtij vendimi, shoqëria KESH sh.a, më datë 05.01.2022, ka publikuar në përputhje me parashikimet e VKM, Thirrje për Shprehje Interesi për marrjen me qira të një asemi gjenerues termik.

Në muajin Prill 2022, u nënshkrua mes palëve (Exelerate dhe Renco & KESH sh.a). Në muajin Shtator 2022, në zonën e Triportit, pranë Petroliferas, u vendosën asetet lundruese.

Në këto kushte dhe në fazën kur asetet lundruese janë vendosur në vendin përfundimtar ku janë ankoruar me tokën dhe kanë përfunduar proceset instalatore për trupëzimin e tyre me infrastrukturën energjitike të vendit, nga ana e shoqërisë bëhet e nevojshme furnizimi e këtyre aseteve gjeneruese me lëndën djegëse të nevojshme gjatë fazës së komisionimit të tyre.

Për këtë arsye, nga ana e shoqërisë evidentohet se për qëllime të furnizimit, nevoja për shërbimin që do të prokurohet është si më poshtë:

Furnizimi në vend me lëndë djegëse i asetit

Asetet lundruese kanë kapacitete të menaxhimit dhe ruajtjes së lëndës djegëse në një total prej rreth 1,000 (një mijë) ton lëndë djegëse. Konsumi i parashikuar i lëndës djegëse për 1 MWh është rreth 229 Kg që do të thotë se, në rastin e shfrytëzimit me kapacitet të plotë të impiantit, nevoja për furnizim është rreth 500 ton lëndë djegëse në ditë, pasi sasia prej rreth 500 ton të tjera do të shërbejë si rezervë kontigjence për garantimin e vijueshmërisë së prodhimit.

Në kuadër të kësaj procedure, furnizimi me lëndë djegëse është parashikuar në përputhje me nevojën e furnizimit për periudhën e komisionimit dhe testimit të asetit termik lundrues.

Bazuar për sa më sipër, nga ana e grupit të punës, më poshtë përcaktohen kërkesat për nevojën e furnizimit me lëndë djegëse për TEC Lundruës, Vlorë.

3. LËNDA DJEGËSE, MËNYRA DHE VENDODHJA E FURNIZIMIT

Për qëllime të funksionimit, këto asete termike kanë nevojën e furnizimit me lëndë djegëse të llojit HFO, përcaktuar në bazë të specifikimeve teknike dhe në referencë të ISO 8217, si ISO RME, me përmbajtje të squfurit jo më të madhe se 0.5%, si dhe sasi të vogla të lëndës djegëse hidrokarbure LFO. (siç është specifikuar në **Aneksin 1** të këtyre termave).

KESH nuk do të pranojë propozime për lëndë djegëse të ndryshme nga ajo e kërkuar, me parametra të ndryshëm nga çfarë është parashikuar dhe që nuk bie nën asnjë klasifikim të standarteve ndërkombëtare të cituara apo të ngjashme.

Furnizimi me lëndë djegëse në vend i dy termocentraleve lundruese janë të stacionuara sipas hartës treguese në **Aneksin 2**. Në këtë vendndodhje është pozicionuar gjithë infrastruktura e nevojshme pritëse e lëndës djegëse e gatshme për përdorim.

Kontraktori duhet të furnizojë lëndën djegëse në vendin e parashikuar në Aneksin 2, nëpërmjet automjeteve të përshtatshme për transportin e kësaj lënde. Transporti i lëndës djegëse duhet të realizohet në mënyrë të tillë që të ruhen karakteristikat e lëndës, të mos krijojnë ndotje mjedisore dhe në përputhje me të gjithë legjislacionin shqiptar për transportimin e lëndëve djegëse. Lënda duhet të transportohet me automjete të specializuara të projektuara për transportin e lëndës së kërkuar, me peshë jo më të madhe se 40 (dyzet) ton/ mjet. Infrastruktura pritëse e ndërtuar pranë termocentraleve lundruese ka kapacitet shkarkimin e 2 (dy) mjeteve njëkohësisht (siç është paraqitur në Aneksin 2). Detajet e tjera në lidhje me logjistikën e shkarkimit në vend do të bëhen të ditura pas finalizimit të kontratës me operatorin fitues.

4. LIDHJA DHE KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kontrata do t'i akordohet operatorit që do shpallet fitues në përfundim të procesit të vlerësimit nga ana e KESH sh.a referuar kritereve kualifikuese dhe çmimit për njësi të produktit. (të përshkruara në dokumentin “Kritere për Kualifikim”). KESH sh.a, do të lidhë kontratë me vetëm 1 operator ekonomik.

KESH nuk do mbajë asnjë përgjegjësi dhe kosto ndaj operatorëve që nuk klasifikohen si fitues në përfundim të procedurës së prokurimit.

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë për një periudhë prej 3 (tre) mujore nga lëvrimi fillestar i furnizimit me lëndë djegëse, kohë e cila do të përcaktohet sipas termave kontraktuale dhe skedulit të dorëzimit.

KESH nuk do të pranojë biofuel apo produkte me karakteristika të ndryshme nga produkti i përshkruar në pikën 3 (Aneksi 1) të materialit.

5. DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË OPERATORIT FITUES

- Ka detyrimin të sigurojë produktin sipas të gjitha kërkesave të këtij dokumenti pa pretendime apo ndryshime
- Ka detyrimin të disponojë të gjithë lejet dhe licencat e nevojshme brenda dhe jashtë vendit
- Ka detyrim të përmbushë të gjitha kushtet mjedisore sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe kërkesave kombëtare.
- Ka detyrim të tregojë gatishmërinë për të komunikuar në lidhje me porositë gjatë fundjavave dhe ditëve të pushimit si dhe gatishmëri 24h gjatë momenteve të furnizimit në vend.
- Ka detyrim të paraqesë të gjithë informacionin e nevojshëm që do kërkohet nga KESH sh.a, në lidhje me origjinën e produktit, mënyrën e përpunimit dhe/ose transportit. Kjo për arsye të përmbushjes së kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- Ka detyrim të lejojë KESH që të realizojë të gjithë proceset e nevojshme të kampionimit, kontrollit të cilësisë dhe gjithë procedurat e nevojshme për të garantuar cilësinë e shërbimit dhe të produktit të ofruar.
- Ka detyrim të përmbushë çdo term të parashikuar në këto dokumente tenderi pa i modifikuar, përshtatur apo neglizhuar.
- Lidhjen me pikën e shkarkimit të lëndës djegëse:
- Respektimin e rregullave teknike dhe të sigurisë përgjatë transportit të lëndës dhe shkarkimit të saj në vendin e përdorimit;
- Sigurimin e impaktit në mjedis përgjatë procesit të transportit kur dërgesa ka destinacion furnizimin e Autoritetit kontraktor.
- Ka detyrim të sigurojë furnizimin në vend të lëndës djegëse me mjetet e përshtatshme të transportit duke përmbushur të gjithë kriteret sipas legjislacionit vendas në fuqi në lidhje me transportin e lëndëve djegëse.
- Të përmbushë të gjitha kërkesat teknike të parashikuara në pikën 3 të këtyre dokumenteve.

6. MËNYRA E OFERTIMIT, SASITË DHE SKEDULI I NGARKESËS

Sasitë dhe skeduli i ngarkesës përshkruhen në **Aneksin 3** të këtyre dokumenteve

Operatorët ekonomik që do të klasifikohen si të suksesshëm për plotësimin e kriterëve të kualifikimit (*dokumenti Kriteret e Kualifikimit*) duhet të ofertojnë nëpërmjet metodologjisë së mëposhtme:

Për sasinë e furnizimit sipas skedulit të parashikuar në Aneksin 3:

- Për lëndën djegëse çmim bazë /ton reference **të ditës së furnizimit në vend S&P Platts Global / Commodities / Marine Fuel Oil 0.5%**. Lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri jo me tepër se 0.5 % ndaj peshës CIF MED (Marine Residual Fuels, RME)
- **Premio / ton** nëpërmjet së cilës duhet të mbulohen të gjitha shpenzimet për transportin, dhe/ose depozimitimin, dhe/ose ngarkim – shkarkimin e lëndës, dhe/ose fitime/shpenzime operacionale etj.

Pagesa totale që KESH do paguajë për këtë produkt është:

Pagesa totale / ton = S&P Platts CIF Med / ton + Premio/ ton

KESH sh.a nuk do të paguajë asnjë kosto shtesë në lidhje me produktin e marrë (përfshijë detyrimet për taksat respektive të cilat përshkruhen më qartë në dokumentin Draft Kontratë)

6.1. Kushtet e Shërbimit

Për TEC Llundres është i nevojshëm që të garantohet furnizim i sigurt me lëndë djegëse, në mënyrë që të garantohet disponueshmëria e asetit gjenerues.

Për të llogaritur nevojën për lëndën djegëse grupi i punës merr në konsideratë regjimet e mundshme të prodhimit të TEC Llundres.

Sasitë e kërkuara të lëndës djegëse do të jenë të përcaktueshme bazuar në përdorimin e asetit gjenerues, i cili drejtpërdrejtë do të jetë i ndikuar nga çmimi i energjisë në tregje, kërkesa për energji, disponueshmëria e kapaciteteve ekzistuese si dhe situata hidrike me efekt në gjenerimin hidrik. Për këtë shkak planifikimi i një sasive fikse të lëndës djegëse të nevojshme për përdorim është i pamundur aktualisht për periudhën deri në dy vite.

Regjimi i përdorimit të TEC Llundres do të ndikojë gjithashtu në disponueshmërinë e depozitës së lëndës djegëse.

Lidhur me çmimin e produktit të kërkuara, bazuar në praktikat brenda vendit, parashikohet që çmimi të jete i formuar nga një reference ne tregjet ndërkombëtare, të cilit i shtohet një çmim Premium.

Pjesëmarrësit do të garojnë mbi çmimin Premium. Çmimi i referencës, bazuar ne praktika dhe Buletinet e APP, do të jetë: Lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri jo me tepër se 0.5 % ndaj peshës , CIF Med, Referuar Platts Marine fuel oil 0,5% CIF Med. Çmimi i referencës për furnizimin në vendin e përdorimit, TEC Llundres do të jetë ai i ditës së dorëzimit në vend.

Për sa i përket çmimit të referencës të furnizimit në vendin e depozitimit, parashikohet të jetë ai i ditës së Njoftimit të gatishmërisë (Notice of Readines, NoR) të transportuesit të lëndës për ta depozituar ate. Tabela përmbledhëse e produktit të kërkuar:

1. Furnizim ne vendin e përdorimit TEC Lundrues

No.	Kushtet kryesore	Komente
1	Data e parë e furnizimit	TBA
2	Blerësi	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (Albanian Power Corporation). Shoqëri aksionare me pronar shtetin
3	Produkti /Grada	Max 0.5% Sulfur RME 180ctss sipas specifikimeve bashkëlidhur
4	Inkoterm	CIF Porti i Peshkimit, Vlore, Shqipëri. Titulli, prona dhe rreziku do të kalojnë nga Shitësi te pala e furnizuar pasi nafta kalon lidhjen e përhershme të fllanxhës së transportit në cisterna.
5	Periudha e dorëzimit	Dorëzimi do të bëhet sipas parashikimit në Aneksin 3 (Skeduli i dorëzimit)
6	Sasia e Kontraktuar	Dorëzimi do të bëhet sipas parashikimit në Aneksin 3
7	Çmimi dhe sasia e referencës fikse	0.5% CIF Ngarkesa mesdhetare e kuotimit të ditës së dorëzimit siç publikohet nga Plats plus një çmim prej "X" \$/mt.
8	Kushtet e pagesës	30 ditë kalendarike pas dorëzimit.
9	Garancia e pagesës	Nuk aplikohet
10	Periudha e furnizimit	3 (tre) muaj
11	Kostoja e inspektimit /Inspektorit	Inspektimi i dorëzimit tek shitësi
12	Ligji & Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve	TBA
13	Termet dhe Kushtet e Kontratës	Standardet e Bankës Botërore Marrëveshja e furnizimit me karburant për termocentralet. TBA

6.2. Karakteristikat e shërbimit

- Furnizimi

Furnizimi do të realizohet sipas llojit të përcaktuar në këtë dokument.

Furnizuesi mund të përdorë transportin rrugor për furnizimin në vendin e përdorimit dhe transportin rrugor ose ujqor për realizimin e furnizimit në depozita.

Furnizimi do të jepet sipas skeduleve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, sipas termave kohore të përcaktuar paraprakisht për sasi të fikse dhe brenda afateve pas kërkesës për sasi të variabël.

7. DOKUMENTACIONI TEKNIK

Operatori duhet të sigurojë dokumentacion se disponon kapacitete teknike, ligjore dhe ekonomike që të ushtrijë veprimtarinë e kërkuar.

Në veçanti në aspektin teknik, është e nevojshme që të deklarohet dhe sigurojë dokumentacion për të vërtetuar se ushtrijë veprimtari në përputhje me kërkesat për siguri të teknike, të shëndetit dhe siguri të mjedisore.

Grupi i punës